



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 07.03.2025

Nr: 249

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 56 ID, DATË 03.03.2025, TË REGJISTRIT TË
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 07.03.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: Zj. Elisa Spiropali
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara konkretisht propozimi dhe miratimi i projektligjit “Për paktën e maleve”, para periudhës zgjedhore

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator,

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 3.3.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 56 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon: “Partia Demokratike denoncon miratimin e projektligjit “Për paktën e maleve”. Miratimi i këtij projektligji është bërë në janar të këtij viti pas diskutimit në Komisionet Parlamentare si dhe në Komision Qendror të Zgjedhjeve.”

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduar (KRIIK), më datë 06.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet protokollit, denoncimin e

Data 07.03.2025

Nr: 249
Ora: 12:00



“Për mos fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 56 ID, datë 3.3.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 4 ID, me objekt parandalimin e miratimit të projektligjit “ Për një shtesë në ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit administrativ ka miratuar vendimin nr. 83, datë 11.02.2023, me anë të cilit në pikën 2 të dispozitivit tij ka vendosur “T”i rekomandojë Kuvendit të Shqipërisë të mos përfshijë për shqyrtim në seancë plenare projektligjin “Për paketën e maleve”, përcaktuar në kalendarin e Kuvendit.

Sa më sipër, neni 90, pika 1,0 e Kodit të Procedurave Administrative, i referohet përfundimit të procedurës administrative, të nisur me kërkesë në rastin konkret me vendimmarrje përfundimtare për çështjen.

Lidhur me rastin objekt denoncimi vlerësohet se, ndodhemi në kushtet e “*gjë-së së gjykuar*”, pasi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar vendimin përkatës lidhur me çështjen në fjalë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Mos fillimin e procedurës administrative të denoncimit nr. 43, datë 21.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI